

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Gjuhë shqipe dhe letërsi/ Gjuhe Shqipe dhe Letërsi
Titulli i lëndës:	Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe
Niveli:	Bachelor – gjuhësi
Statusi lëndës:	zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.asoc. Xheladin Zymberi
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	
	Nëpërmjet këtij kursi studentët do të kenë mundësinë për t'i zgjeruar njohuritë e tyre në një rrafsh përtej fjalisë, duke u njohur me kontekstin e përdorimit të gjuhës, kategorizimin e teksteve, këndvështrimin, kompozicionin dhe varietetet e përdorimit të gjuhës. Kursi përfshin trajtimin e koncepteve gjuhësore, duke mos u ndalur vetëm brenda fjalisë, por duke dalë përtej saj.
Qëllimet e lëndës:	Synim i këtij kursi është që t'u ofrojë studentëve metodë për të analizuar konceptet gjuhësore në rrafsih e plotë tekstor, duke e pasur parasysh se komunikojmë jo përmes fjalive, por përmes teksteve të tëra. Analiza e fjalive si të veçuara shpesh nuk e ofron plotninë e nevojshme, duke i lënë anash kotekstin dhe kontekstin e komunikimit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Rezultatet e pritura: Në përfundimin e këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje: - Të ketë parasyh se analiza gjuhësore nuk përfundon te shenja e pikësimit që shënon përfundimin e fjalisë; - Të arrijë të marrë informacion për disa nga konceptet themelore të studimit të tekstit; - Të krijojë një ide për skemat strukturore dhe tematike të tekstit; Të bëjë analiza bazike të teksteve të ndryshme;

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2 (80min)	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1 (45 min)	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:			
	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave dhe punës praktike të studentëve.</p> <p>Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme dhe të paqarta. Studentët, kanë punime shtëpie që do t'i kryejnë në mënyrë të pavarur e që do të diskutohen dhe kontrollohen në orën e ushtrimeve.</p>		
Metodat e vlerësimit:			
	<p>Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive 10%</p> <p>Detyrat e shtëpisë (seminari) 10%</p>		

	Testi semestral 20 % Punimi final 60 % Gjithsej 100 %
Literatura	
Literatura bazë:	Literatura e nevojshme: - Bardh Rugova, Gjuha e gazetave, KOHA, 2009 - Hasan Mujaj, Gjuhësia e tekstit - Klodeta Dibra, Nonda Varfi, Gjuhësi teksti - Tefë Topalli, Gjuhësi teksti - Egon Werlich, English Text Grammar
Literatura shitesë:	- Hasan Mujaj, Gjuhësia e tekstit - Lindita Tahiri, Gjuha dhe lufta e ideve, Tiranë, 2012 - Arbër Çeliku, Koherenca tekstore - Rexhep Ismajli, Shumësia e tekstit - Rexhep Ismajli, Gjuha shqipe e “Kuvendit të Arbënit” (1706)
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Gramatika e tekstit kundruall gramatikës së fjalisë
Java e dytë:	Historiku i studimeve të tekstit
Java e tretë:	Kategoritë e gramatikës së tekstit
Java e katërt:	Koteksti dhe konteksti
Java e pestë:	Koherenca tekstore
Java e gjashtë:	Tema dhe rema
Java e shtatë:	-Kohezioni gramatikor
Java e tetë:	Kohezioni leksikor
Java e nëntë:	Tipat e tekstit
Java e dhjetë:	Grupet e tekstit dhe format e tekstit

Java e njëmbëdhjetë:	Këndvështrimi: përfaqësimi i tekstit
Java e dymbëdhjetë:	Kohët e foljeve
Java e trembëdhjetë:	Mbiemrat dhe ndajfoljet
Java e katërbëdhjetë:	Njësitë e tekstit
Java e pesëmbëdhjetë:	Stil dhe regjistër

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet t'i ndjekin me rregull ligjëratat. Në rast të mungesave të shumta të paarsyeshme të studentëve nuk do t'u verifikohet pjesëmarrja e rregullt në ligjëratë dhe ushtrime. Studentët janë të obliguar të kenë sjellje të mirë dhe të mbajnë qetësi si dhe t'i fikin telefonat mobilë gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve.

Studentët duhet ta kenë Kartën e UGJFA-së ditën e provimit.